



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

**VENDIM**

*Nr. 6 Datë 23.01.2013*

**MBI**

**ANKANDIN E MUAJIT SHKURT 2013 TE KAPACITETEVE TË  
INTERKONJEKSIONIT**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, gërma “ç”, paragrafi “ii”, dhe 9, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pikës 7, gërma “b”, të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, VKM nr. 924, date 26 Dhjetor 2012 ka vendosur “Lejimin e shoqërisë KESH sh.a, te importojë energji elektrike per periudhen 1.01.2013 deri 1.03.2013 per furnizimin e konsumatorëve tarifore dhe mbulimin e humbjeve ne sistemin e shperndajes”, si dhe Kapitullit X, pika 2, të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike të miratuara nga ERE me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës .01.2013, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut,

**Vendosi:**

1. OST sh.a të alokojë me të drejta të siguruara pa pagesë, shoqërisë KESH sh.a, kapacitetet ndërkufitare të interkonjeksionit për muajin Shkurt 2013, ne drejtim importi, për kryerjen e importit të energjisë elektrike për furnizimin e konsumatorëve tariforë dhe mbulimin e humbjeve në sistem.

2. OST sh.a të zhvillojë ankand për muajin Shkurt 2013 për kapacitetet e mbetura ndërkufitare, ne drejtimin e importit, pas plotësimit të pikës 1 te ketij Vendimi.
3. OST sh.a. te zhvilloje ankandin per muajin Shkurt 2013 per kapacitetet nderkufitare ne drejtim eksporti.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol RAMADANI**